



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 3 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i panjohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 82-të të mbajtur më 14.02.2023 ka miratuar si në vijim.

VENDIM

Veprimi sipas denoncimit me numër 12-6804/1 të datës 14.12.2021, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja vërtetoi se lënda nuk ka elemente për veprim kompetent.

Lënda me numër 12-6804 të datës 2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi në formë të depersonalizuar të publikohet në ueb faqen e KSHPK-së në afat kohor prej 5 (pes) ditëve nga dita e miratimit.

Arsyetim

Lënda me numër 12-6804/1 të datës 14.12.2021 është formuar në bazë të denoncimit të dorëzuar nga ///. Pretendimet e paraqitura në denoncim kanë të bëjnë me dyshime për sjellje të pakujdesshme të detyrës zyrtare nga ana e personit zyrtar në ///, për arsye të mos publikimit të shpalljes publike për furnizime publike të shërbimeve për dhënien me qira të tualeteve portative. KSHPK-së i kërkohet shqyrtimi i çështjes në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në shtojcë të denoncimit nuk është dorëzuar asnjë provë.

Pas shqyrtimit të përmbajtjes së denoncimit, KSHPK-ja kërkoi veprime kompetente nga komuna e lartpërmendur dhe NKP, dhe sipas detyrës zyrtare ka dhënë vendim të shkallës së dytë nga Komisioni Shtetëror për Ankesa për Prokurim Publik të RMV-së. Nga provat e siguruara rezulton si vijon:

/// për /// vit modifikoi planin e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që parashikonte dhënien me qira të tualeteve portative. Kjo pasoi një indikacion të marrë nga vetë parashtruesi.

Në vitin///, procedura e prokurimit publik nr. /// për dhënien me qira të tualeteve portative, në të cilën procedurë, parashtruesi u zgjodh si ofertuesi më i favorshëm.

Pas ankeses sē dorēzuar nga njē operator ekonomik konkurrues, Komisioni Shtetēror pēr Ankesa tē Prokurimit Publik tē RMV-sē ka nxjerrē Vendimin nr. /// tē vitit///, me tē cilin ēshtē respektuar ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik konkurrues dhe ēshtē anuluar procedura e prokurimit publik. Pēr rrjedhojē, /// e pērsēriti kētē procedurē duke publikuar thirrjen publike nr. ///, nē tē cilin, pērveç operatorēve tē tjerē ekonomikē konkurrues, ka marrē pjesē edhe vetē parashtruesi. Procedura u pērmyll me pērzgjedhjen e njērit prej operatorēve ekonomik konkurrues, i cili aplikoi nē shpalljen e shpallur publikisht, i cili u rendit i pari si ofertuesi mē i mirē me çmimin mē tē ulēt tē ofruar.

Nē rastin konkret kanë vepruar organet kompetente, tē cilat kanë marrē vendime pēr tē njējtēn lēndē nga kompetenca e tyre ligjore. Konkretisht, ///, fillimisht ka marrē parasysh sugjerimin e parashtruesit, e mē pas ka parashikuar njē ndryshim nē planin e prokurimit publik pēr vitin ///, ku ishte parashikuar edhe njē prokurim publik pēr dhēnien me qira tē tualeteve portative. Po ashtu, pas shpalljes dhe realizimit tē prokurimit publik pēr dhēnien me qira tē tualetit portativ, ka vepruar edhe autoriteti tjetēr kompetent, i cili ka marrē vendim pēr anulimin e procedurēs sē zbatuar, pēr shkak tē shkëljes esenciale tē procedurēs. Nē procedurē tē pērsēritur janē paraqitur disa operatorē ekonomikē konkurrues dhe kjo procedurē e pērsēritur ka pērfunduar me pērzgjedhjen e ofertuesit mē tē favorshēm. Nga kētū, nuk ka elemente pēr veprime tē mētejshme nē veprimin kompetent tē KSHPK-sē.

Sipas sa mē sipēr KSHPK-ja vendosi si nē dispozitiv tē kētij vendimi.

Dorēzuar:
- parashtruesi.

pērgatiti: Mr. D.D.
miratoi: Mr. V.G

**KOMISIONI SHTETĒRO
PĒR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT**
Nēnkryetare,
Katica Nikolovska